

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Gjyqtari Shaqir Zika, me sekretaren juridike Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. Sh. Sh. dhe S. Gj. D. qe të dytë nga Gjakova, për shkak veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg.2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Gjakove,- Departamenti për Krime të Renda PP/I.nr.1/2017, te dt. 16.02.2017, pas mbajtjes se seancës për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, të mbajtur më dt.27.02.2017, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurorit të Shtetit Ali Uka, të akuzuarit A. Sh. dhe mbrojtësi i tij av. H. P., sipas autorizimit dhe akuzuarit S. D. dhe mbrojtësit te tij av. T. B. sipas detyrës zyrtare, 27.02.2017 mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari: A. SH., nga Gjakova, nga i ati Sh. dhe ëma A. e gjinisë H., i lindur me dt..., ne Gjakove, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa pune, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qene ne paraburgim nga dt. 04.01.2017 deri me dt. 27.02.2017.

2. I akuzuari: S. D., nga Gjakova, nga i ati Gj. dhe ëma V. e gjinisë G., i lindur me dt... , ne Gjakove, ka të kryer shkollën mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qene ne paraburgim nga dt. 04.01.2017, deri me 27.02.2017.

JANË FAJTOR

Të pandehurit A. Sh. dhe S. D., pa autorizim kanë transportuar substancë narkotike e cila me Ligj, është shpallur si narkotikë në atë mënyrë që natën kritike me dt.03.01.2017, rreth orës 23:20 min., ne fshatin Zhub K- Gjakovë, nga ana e një patrullë të Policisë Kufitare DRPK “Perëndimi“ në Gjakovë, është vërejtur një automjet i ndalur i tipit “ Wolsfagen Passat” ngjyrë e kuqe me tabela te regjistrimit... e në të cilinë automjet ndodheshin të pandehurit A. Sh. dhe S. D., ashtu që pas kontrollit dhe bastisjes se personave dhe automjetit në afërsi të ulëses se pasagjerit tek pjesa e këmbeve janë gjetur dhe sekuestruar dy qese plastike, njëra me mbishkrimin Viva Fresh Store, dhe tjetra Meridian, e në to të futura substancë narkotike e që nga raporti mbi ekzaminimin me Nr. AKF /2017- 135/2017- 127, te dt. 02.02.2017, ka rezultuar e llojit “ marihuana “ne peshe te përgjithshëm prej 1.356.52 gr. e të cilën substance narkotike të pandehurve gjerë të automjeti i tyre ju kanë sjellë dy persona te tjerë për momentin te pa njohur te cilët kanë qene ne afërsi të automjetit por me te vërejtur policinë të njëjtit janë larguar nga vendi i ngjarjes ne drejtim te pa njohur.

- me çka si bashke kryes kanë kryer veprë penale blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e pa autorizuar e narkotike substanca psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg.2 lidhur me nenin 31 te KPRK-se,

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 46, 73, neni 273 prg.2 lidhur me nenin 31 te KPRK-se dhe neneve 359 par. 2, 366,450,458 te KPPK-se te akuzuarit ju shqipton:

ME DENIM ME BURGIM DHE GJOBE

Te akuzuarin **A. Sh.** dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, në të cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim, nga dt. 04.01.2017, deri me 27.02.2017, si dhe dënimin me gjobe në shumë prej 800(tetë qind)€, e cila gjobe do te paguhet ne afat prej 15ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po qe se gjoba nuk paguhet i njëjti dënim zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 40 ditëve, duke llogaritur për çdo dite burgimi me nga 20 €.

Te akuzuarin **S. D.** dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, në të cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim, nga dt. 04.01.2017, deri me 27.02.2017, si dhe dënimin me gjobe në shumë prej 800(tetë qind)€, e cila gjobe do te paguhet ne afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po qe se gjoba nuk paguhet i njëjti dënim zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 40 ditëve, duke llogaritur për çdo dite burgimi me nga 20 €.

Të akuzuarve ne fjalë ne kuptim të nenit 69 dhe nenit 273 prg.5 te KPRK-se, u shqiptohet dënimi plotësues i konfiskohet narkotiku i llojit “marihuana“ ne peshë prej 1.356.52 gr. si dhe konfiskohet automjeti i tipit “VW-Passat” me ngjyrë të kuqe me tabela te regjistrimit..., me numër identifikues WWZZZ31ZLE190376, në pronësi të Sh. Sh., ne posedim ka qene të i pandehuri A. Sh..

Të akuzuarit **A. Sh. dhe S. D.**, obligohen që të paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa të jenë sipas llogarisë së kësaj Gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë me nga 50(pesë dhjete) € të gjitha këto ne afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë,-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.1/2017, te dt. 16.02.2017, kundër të akuzuarve A. Sh. Sh. dhe S. Gj. D., ka ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg.2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, me propozim për caktimin e seancës për aprovimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjykata ka caktuar seancën mbi shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ali Uka, i akuzuari A. Sh. dhe mbrojtësi i tij av. H. P., dhe i akuzuari S. D. dhe mbrojtësi i tij av. T. B. nga Gjakova.

Gjykata gjate seancës dëgjimore të shqyrtimit te marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka dëgjuar te akuzuarit, dhe mbrojtësin e tyre, si dhe përfaqësuesin e Prokurorisë Themelore ne Gjakove,-Departamenti për krime te Renda, Prokurori i Shtetit Ali Uka.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se ne tërësi ngel pranë marrëveshjes me nr. PP/I.nr. 1/2017, te dt. 16.02.2017, e cila marrëveshje ka arritur në Gjykatë po me dt. 16.02.2017, e lidhur ne mes te Prokurorit, te akuzuarve dhe mbrojtësit te tyre, te akuzuarit A. Sh. dhe mbrojtësit te tij av. H. P. si dhe te akuzuarit S. D. dhe mbrojtësit te tij av. T. B. për të cilën marrëveshje e lidhur me kushtet dhe llojin e dënimit është e njoftuar Gjykata si dhe vet të akuzuarit. Andaj përveç kushteve te caktuar ne ketë

marrëveshjen si Prokurori, nuk kemi çka te shtojmë dhe i propozojmë Gjykatës që kjo marrëveshje te aprovohet dhe te jete pjesë përbërës ne shkresat e lendes.

Mbrojtësit i te akuzuarit te pare **A. Sh. av. H. P.** ka deklaruar se: duke pasur parasysh bazën për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ne baze te mundësive ligjore, si dhe mundësive te dhëna nga ana e Gjykatës dhe Prokurorit, me Prokurorin e Shtetit kemi arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë e cila sot është objekt shqyrtimi dhe unë si mbrojtës i tij i kam shpjeguar te gjitha bene fitet e marrëveshjes dhe pasojat e pranimit te fajësisë i njëjti me vullnet te tij ka pranuar veprën dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, andaj i propozojmë Gjykatës që ketë marrëveshje te aprovoi dhe te akuzuarit ti shqiptohet dënimi sipas marrëveshjes se arritur, dhe mundësisht dënimi te jete në minimumin e marrëveshjes.

Mbrojtësit i te akuzuarit te dytë **S. D. av. T. B.**, ka deklaruar se: duke pasur parasysh bazën për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ne baze te mundësive ligjore, si dhe mundësive te dhëna nga ana e Gjykatës dhe Prokurorit, me Prokurorin e Shtetit kemi arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë e cila sot është objekt shqyrtimi andaj i propozojmë Gjykatës që të njëjtën marrëveshje te aprovoi dhe te akuzuarit ti shqiptohet dënimi sipas marrëveshjes.

Gjykata pas dëgjimit te pretendimeve te Prokurorit te akuzuarve dhe mbrojtësve te tyre, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka konstatuar se të akuzuarit A. Sh. dhe S. D. kanë kuptuar natyrën dhe pasojat te pranimit te fajësisë, ky pranim është bërë ne baza vullnetare pas konsultimeve te nevojshëm me mbrojtësin e tyre, të akuzuarit nuk kanë qene të detyruar ose të shtrënguar ne asnjë mënyrë që te pranoi fajësinë, pranimi i fajësisë mbështet ne fakte dhe prova te cilat janë paraqitur ne aktakuzë, dhe janë pranuar nga vete të akuzuarit. Po ashtu Gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës, apo te pushimit te procedurës penale te parapara me nenin 248 para 3 te KPPK-se.

Gjykata gjendjen faktike të përshkruar ne dispozitivat te këtij aktgjykimi e ka vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga ana e te akuzuarve por edhe nga provat qe gjenden ne shkresat e lëndës dhe atë nga kallëzimi penale i parashtruar nga Policia e Kosovës, Drejtoria për Trafikim me narkotikut ne Gjakovë, me numër te rastit 2017- YWB- 001, te dt. 05.01.2017, nga raporti i oficerit policor H. K., me numër te rastit te njëjtë dhe date te njëjtë, nga forma e pranim dorëzimit të lëndës ku është sekuestruar substanca narkotike e llojit “Marihuana “ dhe automjeti, nga raporti i hetuesit policore A. Sh., nga deklaratat e të pandehurve te dhëne ne polici ne pranim te mbrojtësve te tyre, si dhe nga foto albumi i vendit te ngjarjes ku shihet substanca narkotike e llojit “ marihuan” e sekuestruar, nga zingjiri ruajtjes si dëftesa nga konfiskimi i pronës, si raportit te shiqimit te vendit te ngjarjes, dhe nga ekspertiza e Agjensionit Kosovare te Forenzikes, me numër AKF /2017-0135/ 2017-127, te dt. 02.02.2017, ku rezulton se substanca është e llojit “ marihuana “ ne peshe të përgjithshëm prej 1.356.52 gr.

Andaj, Gjykata ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elemente qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e pa autorizuar e narkotike substanca psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg. 2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dhe përket ka vendosur qe te pranoi fajësinë e të akuzuarve dhe te akuzuarit ti shpalli fajtoresh dhe te dënoi ne baze te Ligjit.

Gjate seancës për caktimin e dënimit Prokurori i Çështjes ka deklaruar se: mbetet pranë dënimeve te rekomanduar ne marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, për të akuzuarin e parë A. Sh., për vepër penale blerje, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg.2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, ti

shqiptohet dënimi me burgim prej 7 (shtatë) muaj, deri në 9 (nën) muaj, si dhe dënimin me gjobe në shumë prej 600€ (gjashte qind)€ deri në 900€ (nëntë qind)€,

Po ashtu është propozuar që të konfiskohet substanca narkotike në peshe prej 1.356.52gr, si dhe konfiskohet automjeti i tipit “ VW Passat” me ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimit..., me numër identifikues WVWZZZ31ZLE190376, pronë e Sh. Sh. nga Gjakova e që ka qene në posedim të akuzuarit A. Sh.

Për të akuzuarin e dytë S. D. është rekomanduar dënimi për veprë penale, për veprë penale blerje, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg.2 si bashkë kryes lidhur me nenin 31 të KPRK-se, të shqiptohet dënimi me burgim prej 7 (shtatë) muaj, deri në 9 (nëntë) muaj, si dhe dënimin me gjobe në shumë prej 600€(gjashte qind)€ deri në 900€ (nëntë qind)€,

Mbrojtësi i të akuzuarit të parë A. Sh. av. H. P. nga Gjakova, ka deklaruar se e përkrah dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, dhe i propozon Kryetarit të Trupit Gjyqësor që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh si do mos rrethana lehtësuese, për të mbrojtur tim, të shqiptohet dënimi minimal i caktuar në marrëveshje nga se i mbrojturi im është i moshës së re, është penduar për veprën e kryer, me herët nuk ka qene i gjykuar, gjendjen e tij ekonomike është i gjendjes së dobët, dhe ka premtuar se në të ardhëm nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I akuzuari A. Sh. ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, dhe pendohet për veprën e kryer dhe shpreh keq ardhje.

Mbrojtësi i të akuzuarit të dytë S. D. av. T. B. nga Gjakova, ka deklaruar se e përkrah dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, dhe i propozon Kryetarit të Trupit Gjyqësor që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të mbrojtur tim të caktoj minimumin e dënimit të parapare në marrëveshje, dënimin me burgim prej 7 (shtatë) muajve, dhe dënimin me gjobe në shumë prej 600(gjashte qind)€, për shkak se i akuzuari me herët nuk ka qene i Gjykuar, është i moshës së re, gjendjen ekonomike e ka të vështirë, sjelljen korrekte të tij gjatë tërë procedurës, pendimin, premtimin që në të ardhëm nuk do të kryej vepra të tilla po të ngjashme penale, andaj në bazë të këtyre rrethanave i propozoi Gjykatës që të shqiptoj dënimin minimal të përcaktuar në marrëveshje për pranimin e fajësisë.

I akuzuari S. D., ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, dhe pendohet për veprën e kryer dhe shpreh keq ardhje.

Gjykata duke vendosur mbi sanksionin penal juridike të propozuar në marrëveshje ka vlerësuar të gjitha rrethanat komform nenit 73, 75 para 1, pika 1.3, dhe nënti 76 të KPRK-se, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjeti se pranimin e fajësisë nga ana e tyre, në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimin e tyre, për veprën e kryer qëndrimin e tyre korrekte gjatë gjykimit, jo dënueshme rinë e tyre, kushtet ekonomike sociale, andaj Gjykata të njëjtëve, i ka shqiptuar dënimet me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve, dhe dënimin me gjobe në shumë me nga 800(tete qind)€, me shpresë dhe bindje se dënimet e shqiptuara do të arrin qëllimet e dënimit të parapare me dispozitat të nënti 41 të KPK-se.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike dhe automjetit është në pajtim me nenin 69 lidhur me nenin 273 prg.5 të KPRK-se, dhe i njëjti automjete do të dorëzohet në Agjencinë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar si organ kompetent për administrimin e pasurisë së konfiskuar e cila është rezultat i veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe ne emër te paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 450 prg.3 të KPPK-se.

Nga aresyrat e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 prg.1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË, - Departamenti për krime të Renda,
PKR.nr.20/2017, dt. 27.02.2017**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te parashtrohet ankesë, nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afati prej 15 ditëve nga dita e pranimi te aktgjykimit.